



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01-Nr. 104/02-31595/23  
Kaçanik; 06.12.2023

Në mbështetje të nenit 43.3 pika (c) të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221 dhe Ligjit nr.04/L-116, të Rregullorës MF – nr.02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i komunës mori këtë:

## V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE JOKAPITALE

1.Me këtë vendim emërohet Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë Jofinanciare Jokapitale në objektet e **Administratës Komunale, përfshirë zyret ofiqare, Palestër Sportive , Shtëpien e Kulturës , Qkmf-në dhe Amf-të , QPS-në dhe objektet shkollore** respektivisht të identifikojë dhe regjistroj të gjithë inventarin si:

- Mobiljet;
- Telefona fiks, mobil;
- Kompjuter,
- Paisje IT-së;
- Fotokopje;
- Paisje mjekësore;
- Paisje trafiku, si dhe
- Paisje tjera me vlerë apo kosto të blerjes nën 1000 euro.

2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do të jetë në përbërje prej pesë (5) anëtarëve dhe atë:

1. Fadil Qallaku - **kryesues,**
2. Muhamet Fera - anëtarë,
3. Osman Isa - anëtarë,
4. Arbnore Kuka – anëtare,
5. Ardita Raka- anëtare

3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarde, ashtu siç kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces.


4. Obligohet komisioni i formuar sipas pikës 2, që Raportin dhe Regjistrin e kompletuar me shkrim të nënshkruar dhe kopjen në formë elektronike, më së largu deri më datën 29.12.2023, t'ia dërgoj Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financave.

5. Në raportin përfundimtar komisioni duhet që në regjistrin e posaçëm t'i evidentoj mobiljet dhe pajisjet e dalura jashtë përdorimit dhe propozimet për largimin e tyre, me gjendjen e fundvitit të datës 29.12.2023.

**Me këtë vendim të njoftohen:**

1. Anëtarët e komisionit,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financave
3. Arkivi

**Kryetar i Komunës,  
Besim Ilazi**

A handwritten signature in dark ink, appearing to read 'Besim Ilazi', is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01-Nr. 104/02-32033/23  
Kaçanik; 11.12. 2023

Në mbështetje të nenit 43.3 pika (c) të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221 dhe Ligjit nr.04/L-116, të Rregullorës MF – nr.02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenit 73. të Statutit të Komunës, Kryetari i komunës mori këtë:

### **V E N D I M** **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË** **JOFINANCIARE KAPITALE**

1.Me këtë vendim emërohet Komisioni për Inventarizimin dhe Vlerësimin e Pasurisë Jofinanciare Kapitale në pronësi të Organizatës Buxhetore – Komunës së Kaçanikut.

2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do të jetë në përbërje prej pesë (3) anëtarëve dhe atë:

1. Bujar Bajra - kryesues,
2. Hajredin Shehu,
3. Shkodran Sopa - anëtarë,
4. Afrim Fuga – anëtarë

3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarde, ashtu siç kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces.

4. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e pasurive jo-financiare kapitale janë si në vijim dhe gjithëpërfshirja fizike e tyre në nivel organizate si:

- 4.1.1 Ndertesat rezidenciale;
- 4.1.2. Ndertesat jorezidenciale;
- 4.1.3. Objektet tjera komunale;
- 4.1.4. Rrugët;
- 4.1.5. Instalime hidrosanitare;
- 4.1.6. Ujësjellësi;
- 4.1.7. Trotuare;
- 4.1.8. Automjete transporti;
- 4.1.9. Makinaria;
- 4.1.10. Kapitale tjera;
- 4.1.11. Toka;
- 4.1.12. Pasuritë e paprekshme;
- 4.1.13. Investimet në vijim;
- 4.1.14. Pasuria biologjike;

Si dhe përgjegjësitë tjera: Inventarizimi i të gjithë pasurisë jofinanciare – kapitale, verifikimi fizik, cilësorë i gjendjes së tyre, krahasimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen paraprake në regjistrat e pasurive jofinanciare, identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur, identifikimi i pasurive të demtuara dhe jashtëpërdorimit si dhe *Pergatitja e raportit për perfundimin e Inventarizimit jo me largë se data 15.01.2024* dhe dorëzimi të Kryetarit të komunës.

**Me këtë vendim të njoftohen:**

1. Anëtarët e komisionit,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
3. Arkivi

 **Kryetar i Komunës,**  
**Besim Ilazi**  




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



**Zyra e Kryetarit**

01Nr.104/02-32463/23  
Kaçanik, 19.12.2023

Në bazë të nenit 58, pika (m) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01Nr.60/01-12895/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008), nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores MF Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, në bazë të Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë financiare 01Nr.104/02-32463/23, të datës 15.12.2023, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, merr :

**VENDIM**

**PËR DHURIMIN E VETURËS NISAN PATHFINDER SE 2.5 TDI M/T ,OJQ-së  
"HANDIKOS",DEGA KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim bëhet Dhurimi i veturës NISAN PATHFINDER SE 2.5 TDI M/T, me numër serik VSKJVWR51Z0350165, ngjyra e kaltër ,xhip me 5 dyer,7 ulëse, viti i prodhimit 2008, me targa 05Z-26-07,OJQ- së "HAKNDIKOS" , dega në Kaçanik.
2. Dhurimi i veturës bëhet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e OJQ-së "HANDIKOS" , për punë në teren dhe për transportin e personave me aftësi të kufizuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen : Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky Vendim hy në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen :** Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale , Drejtoria për Buxhet dhe Financa, OJQ "HANDIKOS" dhe Arkivi.

**Arsyetim**

Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e OJQ "HANDIKOS" dega në Kaçanik, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka kërkuar nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë financiare, vlerësimin e veturës NISAN PATHFINDER SE 2.5 TDI M/T, për dhurim kësaj organizate. Bazuar në rekomandimin e Komisionit në fjalë, vetura i plotëson kriteret për dhurim.

**Kryetari i Komunës**  
**Besim Ilazi**